



FAQ – Scuola dell’Infanzia
FAQ - Kopshi

**Si mund të regjistroni fëmijën tuaj në kopësht komunal?
(Si dhe kur mund të prezantoni kërkesën e regjistrimit ?)**

Kërkesat e regjistrimit në kopësht komunal duhet të bëhen on-line duke hyrë në faqen e internetit

<https://servizi.055055.it/iscrizionimaternefe/>,

Periudha e regjistrimit, e cila vendoset me anë të një komunikate të Drejtoris së Arsimimit, qëllon, zakonisht, me periudhën Janar/Shkurt të vitit kur fëmija do filloji të ndjeki shkollën (në shtator) dhe me periudhën e treguar në komunikatë MIUR (Ministria e Arsimimit) me të njëjtën subjekt.

Është i mundur regjistrimi në më shumë kopshte?

Jo, m.gj.th mundet, të zgjidhet një kopësht e dytë si alternativë, i dobishm në rast se kërkesa nuk pranohet për shkak të mungesës së vendeve në kopshtin e parë. Si alternativë mund të zgjidhen kopsht komunale dhe shtetërore duke pasur parasysh se sistemi informatik është i bashkuar. Këshillohet të vëhet në kërkesë kopshti i cili ndodhet afër zonës së rezidencës për të përfituar sa më shumë pikë në listë.

Në ç'farë mënyre mund të njohë kopshtin tim të referimit?

Duke vizituar faqen e internetit të Komunës së Firences në këtë adresë: <https://www.comune.fi.it/servizi/cercascuola> dhe duke klikuar në “motore di ricerca scuole di appartenenza”.

Kur marr vesh nëse kërkesa e regjistrimit është pranuar?

Listat e regjistrimeve publikohen në përgjithsi midis Prillit dhe Majit dhe mund të kontrollohen në sitin e Komunës së Firences ose në Shtator nëpër shkollat e zgjedhura.

Në rast se kërkesa nuk është pranuar nga kopshti, ç'farë duhet të bëjë familja?

Është e mundur të bëhet një kërkesë e re regjistrimi, në një kopsht tjetër, dhe mbas skadencës së kohës të parashikuar, mbasi do aprovohet një listë e dytë brenda muajit korrik e cila mund të përdoret për vendet e mundshme në dispozicion.

Kush është kalendari shkollor?

Kalendari shkollor vendoset nga Rajoni i Toskanës, për shkollat në territorin e rajonit.

Kush është orari javor i kopshteve?

Nga ora 8.30 në orën 16.30, nga e hëna në të premte.

Është parashikuar hyrja përpara kohe?

Po, duke bërë kërkesën në momentin e regjistrimit është e mundur të kërkohet hyrja përpara kohe nga ora 7.30 ose nga ora 8.

Shërbimi në kopësht aktivohet vetëm në bazë të një numri kërkesash minimale.

Është parashikuar dalja me një kohë të shtyrë?

Po, duke bërë kërkesën në momentin e regjistrimit është e mundur të kërkohet dalja në orën 17.

Shërbimi në kopësht aktivohet vetëm në bazë të një numri kërkesash minimale.

Si mund të kërkohet dalja përpara kohe?

Daljet përpara kohës duke pasur parasysh orarin e rregullt, nuk duhet të jenë të shpeshta dhe duhet të jenë të motivuara.

Është e mundur të bëhet një kërkesë e veçant për dalje përpara kohe me anë të një formulari që i kërkohet mësueseve, për të dhënë mundësinë e pjesëmarrjes në aktivitete jashtëshkolore (sport, muzik, balet...).

Në kopësht për fëmijët është i mundur gjumi i drekës?

Në kopësht nuk është parashikuar koha e gjumit.

M.g.j.t, mbas drekës janë parashikuar momente për çplodhje dhe pushim.

Zgjedhja e orarit e bërë në fillim të vitit është e detyrueshme?

Po.

Kush merret me ushqimin?

Shërbimi i Ushqimit shkollor i Drejtorisë së Arsimit.

Kush ndihmon fëmijët gjatë drekës?

Edhe rutina e ngrënjes duhet të konsiderohet si një moment edukativ, kjo është arsya për të cilën personeli shkollorë ndihmon fëmijët dhe janë të pranishëm gjatë drekës.

Për fëmijët e regjistruar në kopësht, regjistrimi në shërbimin e mensës është automatik?

Jo, për ata të cilët zgjedhin shërbimin me kohë të gjatë (deri në orën 16:30) duhet plotësuar dhe formulari i ushqimit.

Për ç'do gjë lidhur me mensën kujt duhet ti drejtoheni, për kërkesa të veçanta mbi mensën, për motive shëndetsore ose fetare?

Janë të mundura ndryshime të menus (të ekspozuara në çdo shkollë) në raste alergjie ose intolerance (të vërtetuara nga çertifikata mjekësore) ose për motive etike dhe fetare (shërben një autoçertifikat.) Kërkesa duhet bërë në momentin e regjistrimit, duke përjashtuar rastet kur problemet shfaqen gjatë vitit shkollor. Është e mundur gjithashtu, të kërkohet për jo më shumë se tre ditë rradhas një vakt “i bardh” (in bianco), në prani të shqetësimeve gastrointestinale pa u vërtetuar nga çertifikata mjekësore.

Kush janë gjërat që fëmijët duhet të kenë gjithmonë?

Këshillohet që fëmijët të vishen në mënyrë praktike (për shembull me tuta, këpucë që mbyllen me ngjitse) dhe me rroba që mund të bëhen pis me ngjyra ose ngjitëse.

Duhet të lehen në shkollë, në një çant stofi ose në një kuti, rrobat për tu ndërruar (ndrresat, rrobat, këpucët) të cilat duhet të përdoren në rast nevojë dhe që duhet të kontrollohen rregullisht edhe në lidhje me ndërrimin e stinëve.

Në çantën e fëmijës, duhet vënë një got plastike, një picet dhe një gushore, çanta duhet të kontrollohet çdo natë. Në të gjitha sendet e fëmijës duhet shënuar emri.

Fëmija vesh përparse?

Nuk egziston një rregull i përgjithshëm për të gjitha shkollat. Ka disa shkolla në të cilat kjo kërkohet dhe disa të tjera në të cilat nuk kërkohet. Kuminikimi për këtë gjë bëhet nga personeli shkollor në mbledhjen e parë me familjet e fëmijëve të sapo regjistruar.

Pranohen në shkollë fëmijë të cilët nuk janë akoma autonom në përdorimin e shërbimeve igjenike, osse më mirë ata të cilët përdorin akoma panolinon?

Po, edhe se preferohet që fëmijet të kenë arritur një autonomi të kënaqshme.

Kush merret me higjenën e shkollës?

Personeli E.S.E (Esecutori Servizi educativi) dhe operatorët e jashtëm, të cilët ndjekin protokolle të veçanta për pastrimin e rregullt të ambjenteve.

Ka një protokoll të veçant në rastin kur shfaqen parazitë?

Po: egzistojnë këshilla specifike nga ASL (Ministria e Shëndetësisë) për sa i përket sjellejes së mësuesve dhe prindërve në rastin kur shfaqen parazitët. Këshillohet të kontrollohen rregullisht flokët e fëmijëve për të verifikuar n.q.f kanë vezë ose morra, dhe në këtë rast duhen njoftuar sa më shpejt mësueset të cilat do këshillojin ç'farë sjellje duhet patur.

Si mund të bëhet kërkesa për mësimin e fesë katolike?

Në momentin e regjistrimit, familja ka të drejtën të zgjedhë të regjistroji ose jo fëmijën, për gjithë vitin, në mësimin e fesë katolike. Janë parashikuar aktivitete alternative për fëmijët të cilët familjet nuk kanë bërë kërkesën.

Ç'farë është P.T.O.F.?

Është Plani trivjeçar i Ofertës Formative, dokument i cili sjell identitetin kultural dhe projektiv të çdo kopshi, hartohet në mënyrë autonome për sa i përket didaktikës dhe bazohet në Indikacionet Nacionale për Planin Arsimor, të parashikuara nga MIUR (Ministria e Arsimit) dhe linjat e ndjekura nga Shërbimi Shërbimet për Fëmijët (Servizio Servizi all'Infanzia) i Komunës së Firences.

Ky dokument parashikon aktivitete si: pritja, përfshirja/shoqërimi, vazhdimësia edukative, raporti me territorin, dokumentimi i aktiviteteve.

Mund të zgjidhet grupi në momentin e regjistrimit?

Jo, edhe sepse regjistrimi bëhet për shkollën dhe jo për grupin.

Kush janë kriteret e formimit të grupeve?

Kolegji i Mësuesve i çdo shkolle procedon në formimin e grupeve në baz të kriterëve të treguara nga Komunikata e Regjistrimeve dhe të vendosura nga Shërbimi. Këto kriterë i përkasin: ekuilibrit numerik duke pasur parasysh tre fashat e moshës, gjinis, nënshtetësis, situatave të vështira.

Kam dy fëmijë të cilët duhet ti regjistroji në kopësht, është e mundur të futen në të njëjtin grup?

Jo, për të favorizuar dhe shtuar autonomin personale, kuptimin e qytetarizimit dhe formimit të identitetit, në momentin e formimit të grupeve, fëmijët që i përkasin të njëjtës familje futen në grupe të ndryshme.

Si dhe kur mund të njihet formimi i grupeve?

Lista e grupeve bëhet publike në çdo shkollë në shtator.

Kush janë, momentet, e parashikuara dhe të shënuara në kalendar, të komunikimit midis shkollës dhe familjes?

- **Mbledhje me prindërit e fëmijëve të rinj të regjistruar:** bëhet në fund të Qeshorit ose në fillim të Shtatorit para fillimit shkollor, kjo varet nga zgjedhja që bën çdo shkollë.
- **Prezantimi i P.T.O.F.** (Piano Triennale dell'Offerta Formativa): bëhet midis Tetorit dhe Nëntorit për ti shpjeguar familjeve Planin Edukativ të Shkollës, i cili i përket vitit në vijim.
- **Intervista individuale:** është e garantuar të paktën një herë në vitë për çdo familje, duke pasur parasysh faktin që mësueset janë të disponueshme të

fiksojin intervista në rastin kur familja bën kërkesë dhe mësueset e shofin të arsyeshme.

- **Bledhje të grupeve:** takime midis prindërve dhe mësuesve në çdo grup.
- **Verifikimi i P.T.O.F.:** bëhet në fund të vitit shkollor për të verifikuar së bashku me famijet sa është arritur më anë të Projektit Edukativ të Shkollës.

Është e mundur të kërkohet soministrimi i ilaçeve nga ana e personelit shkollorë?

Po, në rast kur një fëmija duhet të marri ilaçe të cilat shpëtojnë jetën ose të nevojshme gjatë orarit shkollorë, është e nevojshme që familja të prezantoji një certifikat mjekësore dhe të autorizoj mësueset me anë të një formulari të veçant.

Mbas sa dite mungese duhet të çohet certifikata mjekësore?

Çertifikata mjekësore për të ripranuar fëmijën në shkollë mbas një sëmundjeje është e nevojshme me një mungesë mbi 5° ditë (për kthimin në shkollë në ditën e 6° është e nevojshme certifikata); ditët e festave quhen vetëm në rast se i bashkohen ditëve të sëmundjes (për shembull: 1. kur fillon mungesa të premtën, rikthimi në shkollë deri të mërkurën e ardhshme nuk ka nevoji për certifikat, nga e enjtja e ardhshme dhe më pas po; 2. fillon mungesa të hënën, për kthimin në shkoll të hënën e ardhshme nuk ka nevoji për certifikat, nga e marta e ardhshme po).

Në raste kur vëhet allçi, qepje dhe mjekime është e mundur të pranohet në shkollë fëmija me një deklarat e nënshkruar nga prindërit.

PËT TË QËNË GJTHMONË TË AZHORNUAR VIZITONI SITIN E INTERNETIT

<http://educazione.comune.fi.it/3-6anni/index.html>